



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës së Jugut
Opština Juzna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

KUVENDI I KOMUNËS SË MITROVICËS SË JUGUT

Nr. 02-060/01- 0078642/25 dt. 30.12.2025

Mitrovicë

Në zbatim të nenit 43, të Ligjit Nr. 03/L-040 Për vetëqeverisje lokale; nenit 3, paragrafi 1, nënparagrafi 1.2, dhe nenit 5, të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 02/2015 për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës; nenit 50, paragrafi 1, nënparagrafi 1.2, dhe nenit 52, paragrafi 1, të Statutit të Komunës së Mitrovicës; me kërkesë të Kryetarit të Komunës anëtar i më i vjetër i Kuvendit të Komunës për të **hënën** më dt. **12.01.2026**:

T H Ë R R E T

Mbledhjen e rregullt të Kuvendit të Komunës
Seanca e 2-të

Mbledhja do të ketë këtë:

REND DITE:

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja inauguruese e Kuvendit të Komunës
2. Zgjedhja e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës
3. Propozim-vendim për formimin e Komitetit për Politikë dhe Financa
4. Propozim-vendim për formimin e Komitetit për Komunitete

Mbledhja do të mbahet në Sallën e Kuvendit duke filluar nga ora 10:00.

Mitrovicë

Kryesuesi i mbledhjes

Naser MUJA



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës së Jugut
Opština Juzna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

KUVENDI I KOMUNËS SË MITROVICËS SË JUGUT
Nr. 02-060/01-74203/25 dt. 12.12.2025
Mitrovicë

PROCESVERBAL
Nga mbledhja inauguruese e Kuvendit të Komunës
Seanca e 1-rë

Koha: 12.12.2025 ora 12:00

Vendi: Qendra e Kulturës “Rexhep Mitrovica”

Të pranishëm: Anëtarët e Kuvendit: Shkëlqim Ibrahim, Fisnik Suma, Majlinda Kurti, Igballe Islami, Ferdi Kadriu, Artan Berisha, Egzon Hamza, Gëzim Stavileci, Egzon Sadiku, Valon Brahimi, Liridona Muharremi, Nazmije Sejdiu, Armend Begu, Jeton Zeneli, Kushtrim Zeneli, Erseka Barani, Naser Muja, Rinesa Preteni, Sazan Ramaxhiku, Afërdita Hajrizi, Visar Sylja, Xhevdet Osmani, Elfate Ademi Bahtiri, Safet Kamberi, Oltion Ahmeti, Xhylljeta Imeri, Arta Neziri, Gjergj Beka, Jeton Ujkani dhe Flamur Vojvoda
Kryetari i Komunës z. Faton Peci
Z. Imri Demelezi, Ministër në MBPZHR
Përfaqësues të FSK-së
Përfaqësues të Policisë së Kosovës
Hoxhë Ekrem Avdiu, Kryetar i KBI-së Mitrovicë
Don Ben Zymi, Famulltar i Kishës Katolike në Mitrovicë
Ish Kryetari i Komunës z. Mursel Ibrahim
Ish Kryetari i Komunës z. Agim Bahtiri
Arjeta Fejza
Famulltarë të Kryetarit të Komunës
Përfaqësues të OSBE-së
Përfaqësues të Shoqërisë Civile
Mediat
Mysafirë tjerë
Mungoi: Arian Tahiri

Mbledhjen e hapi Kryetari i sapo zgjedhur i Komunës z. Faton Peci i cili pasi përshëndeti përfaqësuesit e partive politike, mysafirët, ish kryetarët e Komunës së Mitrovicës z. Mursel Ibrahim dhe z. Agim Bahtiri, z. Imri Demelezi - Ministër në MBPZHR, familjarët, nënën dhe bashkëshorten, asamblistët e të gjitha partive politike theksoi se ka pasur fatin dhe nderin, duke u bazuar në besimin qytetarë që i është dhënë nga qyteti i Mitrovicës që të ftojë mbledhjen inauguruese të Kuvendit të Komunës, për të dhënë betimin të gjithë kandidatët e zgjedhur të të gjitha subjekteve politike, por njëkohësisht për të dhënë betimin edhe ai si Kryetar i zgjedhur i Mitrovicës. Në përputhje me legjislacionin, praktikën dhe procedurën, për të kryesuar këtë mbledhje Kryetari ftoi anëtarin më të moshuar në mbledhje z. Naser Muja.

Kryesuesi i mbledhjes z. Naser Muja: Të nderuar përfaqësues të Kuvendit Komunal, të nderuar përfaqësues të institucioneve, të nderuar përfaqësues të shoqërisë civile, të mediave, i nderuar

Kryetar i Mitrovicës ztr. Faton Peci dhe mbi të gjitha, të dashur qytetarë të Mitrovicës. Është nder i veçantë për mua, si anëtar më i vjetër i këtij Kuvendi, të hap sot punimet e seancës inauguruese të mandatit të ri. Kjo ditë nuk është vetëm fillimi i një procesi institucional; është fillimi i një kapitulli të ri për komunën tonë, për familjen tonë, dhe për të ardhmen e qytetarëve të Mitrovicës së Jugut. Sot ne jemi të mbledhur këtu për të marrë një përgjegjësi të madhe për të shërbyer me përkushtim dhe integritet. Qytetarët kanë besuar te ne, dhe ky besim nuk duhet të merret kurrë i mirëqenë. Ata presin rezultate, presin ndryshim, presin qeverisje të drejtë dhe transparente. Ata presin një Kuvend që punon për ta, e jo për interesa të ngushta politike. Të dashur kolegë, në themel të punës sonë duhet të jetë një parim i thjeshtë, por shumë i rëndësishëm: Çdo vendim që marrim duhet të përmirësojë jetën e qytetarëve. Qytetarët kërkojnë rrugë më të mira, shërbime administrative më të shpejta, shkolla dhe kopshte më të sigurta, një mjedis të pastër, lagje të gjelbëruara, dhe mbi të gjitha, institucione që i dëgjojnë dhe u përgjigjen. Ata duan një komunë që kujdeset për njerëzit e saj, për të moshuarit që kanë nevojë për mbështetje, për familjet në vështirësi, për personat me aftësi të kufizuara, për të rinjtë që duan mundësi dhe perspektivë. Dhe ne, si përfaqësues të tyre, nuk kemi të drejtë të anashkalojmë këto nevoja, përkundrazi, jemi këtu që t'i mbrojmë, t'i përfaqësojmë dhe t'i përmbushim. Askush nuk mund të mohojë që komuna jonë ka sfida të shumta. Nga infrastruktura e papërfunduar, tek nevoja për shërbime më të mira publike; nga papunësia tek sfidat sociale; nga mungesa e mjediseve rekreative, tek nevoja për më shumë siguri në çdo lagje. Por këto sfida nuk duhet të na frikësojnë. Ato duhet të na motivojnë. Kemi mundësinë të bëjmë një ndryshim të dukshëm: Të avancojmë projektet infrastrukturore me efikasitet dhe transparencë. Të përmirësojmë cilësinë e arsimit dhe të mbështesim shkollat tona. Të mbrojmë mjedisin dhe të krijojmë më shumë hapësira të gjelbra. Të mbështesim ekonominë lokale dhe krijimin e vendeve të reja të punës. Të rrisim investimet në kulturë, sport dhe rininë e qytetit tonë. Këto nuk janë vetëm ide; janë nevoja reale të komunitetit. Dhe janë projekte që kërkojnë bashkëpunim, vizion dhe vendimmarrje të guximshme. Sot, në këtë sallë, kemi përfaqësues nga parti të ndryshme politike, me qëndrime e ide të ndryshme. Kjo është pasuria e demokracisë. Por, përtej dallimeve, ne kemi një përgjegjësi të përbashkët: t'u shërbejmë qytetarëve të Mitrovicës. Dhënia e votës nuk na ka dërguar këtu për të debatuar pafund, por për të gjetur zgjidhje. Jo për të krijuar barriera, por për t'i hequr ato. Jo për t'u ndarë, por për t'u bashkuar në misionin e përbashkët të zhvillimit. Ju ftoj të punojmë me respekt për njërin-tjetrin, me vullnet për bashkëpunim dhe me synimin që çdo vendim i këtij Kuvendi të jetë në interes të përgjithshëm. Ne mund të kemi mendime të ndryshme, por duhet të kemi një qëllim të përbashkët: përmirësimin e jetës së qytetarëve. Le të pranojmë hapur: qytetarët presin më shumë nga ne. Presin më shumë transparencë, më shumë efikasitet, më shumë përgjegjësi. Presin që ky Kuvend të jetë zëri i tyre, jo zëri i interesave të mbyllura. Le t'i japim fund praktikave të vjetra që pengojnë zhvillimin. Le të sjellim frymë të re, mendim të ri dhe energji pozitive. Le të fokusohemi tek ajo që është me të vërtetë e rëndësishme: Të krijojmë një komunë ku qytetarët ndihen të sigurt, të respektuar dhe optimist për të ardhmen.

Në vazhdim Kryesuesi i mbledhjes theksoi se rendi i ditës i paraparë për këtë mbledhje është:

1. Dhënia e betimit nga anëtarët e Kuvendit të Komunës
(Formimi i Komisionit për verifikimin e mandateve)
2. Dhënia e betimit të Kryetarit të Komunës

Pika 1

Kryesuesi i mbledhjes z. Naser Muja ftoi subjektet më të mëdha politike të përfaqësuara në Kuvend që të propozojnë nga një anëtar për Formimin e Komisionit për verifikimin e mandateve të anëtarëve të Kuvendit.

Z. Shkëlqim Ibrahim i nga radhët e PDK-së e propozoi z. Artan Berisha.

Z. Armend Begu nga radhët e VV-së e propozoi z. Kushtrim Zenelin.

Z. Olti Ahmeti nga radhët e LDK-së e propozoi znj. Xhyljeta Imeri.

Anëtarët e Kuvendit u pajtuan me përbërjen e Komisionit.

Kryesuesi i Komisionit u zgjodh z. Kushtrim Zeneli.

Pas verifikimit të mandateve nga ana e Komisionit, z. Zeneli i njoftoi të pranishmit se në mbledhjen inauguruese të Kuvendit të Komunës së Mitrovicës së Jugut janë të pranishëm 30 anëtarë të Kuvendit të Komunës, mungon vetëm një, z. Arian Tahiri nga radhët e PDK-së.

Kryesuesi i mbledhjes z. Naser Muja ftoi anëtarët e Kuvendit ta japin Betimin, Kryesuesi ta lexojë tekstin e betimit dhe anëtarët e Kuvendit ta përsërisin bashkërisht.

Unë, _____, betohem (ose deklaroj solemnisht) se do t'i kryej me nder, besnikëri, pa anime e me ndërgjegje dhe sipas ligjit detyrat dhe do t'i ushtroj autorizimet e mia si anëtar i Kuvendit të Komunës së Mitrovicës, në mënyrë që të sigurohen kushte për jetë të qetë për të gjithë.

(Duartrokitje)

Pika 2

Kryesuesi i mbledhjes z. Naser Muja falënderoi anëtarët e Kuvendit dhe ftoi Kryetarin e zgjedhur të Komunës z. Faton Peci ta jap betimin.

Kryetari Faton Peci: Betohem që do t'i kryej detyrat dhe do t'i ushtroj kompetencat si Kryetar i Komunës së Mitrovicës, me nder, besnikëri, në mënyrë të paanshme, me ndërgjegje dhe në pajtim me ligjin, në mënyrë që t'i siguroj kushte për një jetë të qetë për të gjithë.

(Duartrokitje)

Kryesuesi i mbledhjes z. Naser Muja ftoi Kryetarin e Komunës z. Faton Peci për një fjalë rasti.

Kryetari Faton Peci: Të nderuar përfaqësues të institucioneve qendrore dhe lokale, i nderuar Ministër i MBPZHR-së z. Imri Demelezi, të nderuar ish kryetarë të Komunës së Mitrovicës z. Mursel Ibrahimimi dhe z. Agim Bahtiri, e nderuara deputete e Kuvendit të Republikës së Kosovës znj. Arjeta Fejza, të nderuar përfaqësues të mekanizmave të sigurisë nga Policia dhe Forca e Sigurisë së Kosovës, përfaqësues të klerit fetar, përfaqësues të familjeve të dëshmorëve, e nderuara familje Boletini dhe gjithë ju përfaqësues të MAPL-së që e monitoroni seancën inauguruese të Kuvendit por edhe seancat tjera, i nderuar Sekretar z. Jeton Qela, të dashur të pranishëm dhe mbi të gjitha të dashur qytetarë, iu përkulem me përulësi dhe përgjegjësi. Njerëz të mrekullueshëm të Mitrovicës sime. Sot, kur po betohem, nuk kam fjalë të mëdha, por kam një premtim të singertë: kam ardhë që, i armatosur me përkrahjen tuaj, t'i dalë zot Mitrovicës. Jam përjetë mirënjohës për besimin tuaj – është përgjegjësia më e madhe që njeriu mund ta marrë nga qyteti i vet. Mitrovica, ky qytet i historisë, krenarisë, rezistencës, vuajtjes, durimit e mosdorëzimit dhe ku çdo kalldrëm është i larë me gjak, këtë vit ka bërë për mua maksimumin e mundshëm, prandaj përgjegjësia është tepër e lartë. Nga sot, dera ime është e hapur për secilin, pa dallime me e pa protokoll. Do të punoj me ndershmëri, me zemër, me durim e me drejtësi, për me e kthye dinjitetin e Mitrovicës. S'ju premtoj mrekulli, por ju premtoj punë të ndershme, çdo ditë. E, nëse bashkë e mbajmë fjalën, ky qytet, që është qyteti më i bukur nën këtë diell, ka me ecë përpara: me nder, qetë, sigurt e me kokën lart. Ashtu si e meriton Mitrovica. Për këtë, na duhet angazhim e përpjekje dhe unë jam i gatshëm me dhanë gjithçka nga vetja për të arritur këtë objektiv. Na duhet dashni për qytetin, na duhet kujdes, na duhet përkushtim, sepse Mitrovica është jo vetëm qyteti ynë, por është edhe zemra e Kosovës. Le të fillojmë një kapitull të ri për Mitrovicën, duke e ndjerë secili prej nesh peshën e historisë dhe përgjegjësisë dhe duke pasur në mendje e në zemër gjithë ata që kanë dhënë jetën për shqiptari, që nga Isa Boletini e deri tek Afrim Bunjaku. Na qoftë për hajr e na priftë e mbara!

Kryesuesi i mbledhjes z. Naser Muja mbylli seancën.

Mbledhja përfundoi punimet në ora 12:36 min.

Mitrovicë

Procesmbajtës:

Kryesuesi i mbledhjes

Merita PRETENI

Naser MUJA



KRYETAR I KOMUNËS SË MITROVICËS SË JUGUT

DATE/A:	30.12.2025
REFERENCE:	Nr. 02-020/04-0078675/21
PËR/ZA/TO:	Kuvendin e Komunës
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	Z Faton Peci – Kryetar i Komunës së Mitrovicës së Jugut
NGA/OD/FROM:	Nazmi Jashari - Udhëheqës i Sekretarisë së Kuvendit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Propozim Vendim Për formimin e Komitetit për Politikë dhe Financa

Në bazë të nenit 12, paragrafi 2, alineja d, dhe nenit 51, paragrafi 1, dhe 58 pika h, të Ligjit Nr. 03/L-040 Për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", Nr. 28/2009); nenit 3, paragrafi 2, dhe neneve: 4, 5 dhe 6, paragrafi 3, të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 05/2020 Për procedurën e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e komiteve të përhershme në komunë; nenit 5, të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 02/2015 Për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës; si dhe nenit 13, paragrafi 1, nënparagrafi 1.4, dhe nenit 50, paragrafi 1, nënparagrafi 1.2, 77 paragrafi 1 nënparagrafi 1.10 të Statutit të Komunës, Kuvendit të Komunës i propozoj këtë:

PROPOZIM VENDIM

Për formimin e Komitetit për Politikë dhe Financa

1. Të FORMOHET Komiteti për Politikë dhe Financa në përbërje (jo me shumë se 7 anëtarë).
2. Komiteti për Politikë dhe Financa kryesohet nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës dhe përbërja e tij duhet të reflektoj përfaqësimin e entiteteve politike në Kuvendin e Komunës.
3. Entiteti politik më numrin më të madh të vendeve, varësisht nga përqindja e përfaqësimit në kuvend do të përfaqësohet edhe në komitet, vazhdon më entitetin e dytë që ka numrin më të madh të anëtarëve të kuvendit e kështu me radhë derisa të ndahen të gjitha vendet në komitet.
4. Komiteti për politikë dhe financa duhet të reflektoj barazinë gjinore në pajtim me legjislacionin në fuqi.
5. Komiteti për Politikë dhe Financa është përgjegjës për:
 - 2.1 Shqyrtimin e të gjitha politikave, dokumenteve fiskale dhe financiare, si dhe dokumentet e planifikimit strategjik;
 - 2.2 Kornizën vjetore buxhetore dhe atë afatmesme;
 - 2.3 Planin vjetor të Prokurimit;
 - 2.4 Rregulloren vjetore për talimet, tarifat dhe pagesat;
 - 2.5 Buxhetin vjetor afatmesëm dhe çdo ndryshim të buxhetit gjatë vitit fiskal; si dhe
 - 2.6 Marrjen e raporteve nga Kryetari dhe dorëzimin e rekomandimeve në Kuvendin e Komunës.
6. Komiteti për Politikë dhe Financa kryesohet nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës.
 - 3.1 Në rastet kur në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa mungon Kryesuesi, mbledhja kryesohet nga anëtari më i moshuar i komitetit.
7. Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa nuk kanë të drejtë të jenë edhe anëtarë të komiteve të tjera.
8. Mandati i anëtarëve të Komitetit për Politikë dhe Financa është 4 vjeçar dhe përfundon me përfundimin e mandatit të Kuvendit të Komunës.
9. Vendimi shpallet tridhjetë (30) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë përgjegjëse për Vetëqeverisje Lokale dhe hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në gjuhët zyrtare në ueb faqen e Komunës së Mitrovicës së Jugut.



KRYETARI I KOMUNËS SË MITROVICËS SË JUGUT

DATE/A:	30.12.2025
REFERENCË:	Nr. 02-020/04-0078686/21
PËR/ZA/TO:	Kuvendin e Komunës
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	Z Faton Peci – Kryetar i Komunës së Mitrovicës së Jugut
NGA/OD/FROM:	Nazmi Jashari - Udhëheqës i Sekretarisë së Kuvendit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Propozim Vendim Për formimin e Komitetit për Komunitete

Në bazë të nenit 12, paragrafi 2, alineja d, nenit 51, paragrafi 1, nenit 53, dhe 58 pika h, të Ligjit Nr. 03/L-040 Për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", Nr. 28/2009); nenit 3, paragrafi 2, dhe neneve: 7, 8, 9 dhe 10 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 05/2020 Për procedurën e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e komiteteve të përhershme në komunë; si dhe nenit 13, paragrafi 1, nënparagrafi 1.4, nenit 61, paragrafi 1, dhe 77 paragrafi 1 nënparagrafi 1.10 të Statutit të Komunës; Kuvendi i Komunës në mbledhjen e rregullt të mbajtur më dt. 22.12.2021; sjell këtë:

PROPOZIMVENDIM

Për formimin e Komitetit për Komunitete

1. Me këtë propozim vendim propozohet të FORMOHET Komiteti për Komunitete.
2. Komiteti për komunitete përbëhet nga anëtarët e Kuvendit të Komunës dhe përfaqësuesve të komuniteteve.
3. Komiteti për komunitete përbëhet nga së paku një përfaqësues i komuniteteve jo shumicë që jetojnë në komunë.
4. Përfaqësuesit e komuniteteve jo shumicë në komunë e përbejnë shumicën e anëtarëve të komitetit për komunitete, i cili komitet duhet të reflektoj barazinë gjinore në pajtim me legjislacionin në fuqi.
5. Komiteti për Komunitete është përgjegjës për:
 - 2.1 Promovimin dhe afirmimin e të drejtave dhe interesave të komuniteteve dhe shqyrton çdo shkelje që bëhet në këtë drejtim dhe bënë rekomandim në Kuvendin e Komunës;
 - 2.2 Shqyrtimin e të gjitha politikave komunale, praktikave dhe aktiviteteve për t'u siguruar se të drejtat dhe interesat e komuniteteve respektohen plotësisht;
 - 2.3 Për të shprehur, mbrojtur dhe zhvilluar identitetin e tyre etnik, kulturor, fetar dhe gjuhësor;
 - 2.4 Sigurimin dhe mbrojtjen adekuate të komuniteteve brenda komunës.
6. Zgjedhja e Kryesuesit të Komitetit për Komunitete bëhet me shumicën e votave të anëtarëve të Komitetit për Komunitete.
7. Komiteti për Komunitete e dorëzon në Kuvendin e Komunës raportin vjetor informues për punën e tyre më së largu deri në fund të muajit mars të çdo viti për vitin paraprak.
8. Mandati i anëtarëve të Komitetit për Komunitete është i lidhur me mandarin e anëtarëve të Kuvendit të Komunës.
9. Vendimi shpallet tridhjetë (30) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë përgjegjëse për Vetëqeverisje Lokale dhe hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në gjuhët zyrtare në ueb faqen e Komunës së Mitrovicës së Jugut.